



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Inspektim



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 4600 Më Dt. 04.11 2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Duke marrë parasysh rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit nga mbeturinat të cilat janë evidente në territorin e komunës së Rahovecit, Drejtoria për Inspektim në Komunën e Rahovecit, lëshon këtë:

NJOFTIM


Njoftohen të gjithë qytetarët dhe familjet e komunës së Rahovecit, se duke marrë parasysh rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit si dhe rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve të komunës së Rahovecit nga mbeturinat të cilat janë evidente në territorin e komunës së Rahovecit, Drejtoria për Inspektim në Komunën e Rahovecit do të ndërmerr veprime të nevojshme dhe konkrete për ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve në komunën e Rahovecit.

Me këtë rast, me anë të këtij njoftimi, kërkojmë nga të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit të cilët nuk kanë marrëveshje dhe kontratë me kompanitë të cilat operojnë dhe merren me mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës së Rahovecit si "Ekoregjioni" dhe "Ekodrinia", ta bëjnë këtë sa më shpejt, pasi që në të kundërtën Inspektorët e komunës së Rahovecit janë të obliguar që të marrin masa të tjera si shqiptimi i gjobave mandatorë, të parapara me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës për personat të cilët nuk lidhin kontratë dhe nuk regjistrohen në kompanitë të cilët janë të licencuara dhe të kontraktuara nga Komuna e Rahovecit për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave.

Andaj, me anë të këtij njoftimi lusim të gjithë qytetarët dhe familjet e komunës së Rahovecit, që në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** nga dita e shpalljes së këtij njoftimi të paraqiten në zyret e kompanive të cilat merren dhe operojnë me mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës së Rahovecit, të bëjnë marrëveshje mbi grumbullimin e mbeturinave nga ana e kompanive të lartpërmendura siç parashihet me legjislacionin në fuqi. Në të kundërtën, Drejtoria për Inspektim në komunën e Rahovecit, respektivisht inspektori për mjedis do të jetë i detyruar që të shqiptojë gjoba mandatorë për personat e papërgjegjshëm, siç parashihet në legjislacionin në fuqi.

Komuna e Rahovecit është e përkushtuar që qytetarëve të vet tu ofroj një ambient të pastër dhe pa mbeturina me qëllim të ruajtjes së ambientit dhe shëndetit të qytetarëve të saj, si dhe ndërgjegjësimin e personave të papërgjegjshëm të cilët hedhin mbeturina në vende të cilat nuk janë të caktuara për mbeturina.

Me këtë rast, lusim të gjithë qytetarët e komunës sonë që të mbrojnë ambientin dhe rethrin në të cilin jetojmë sepse kështu ruajmë ambientin dhe shëndetin tonë dhe të fëmijëve tanë.



Besnik Hoti

Drejtori